



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 618/2 Prot

Tiranë, më 13/04 /2012

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, "XH & L CONSTRUCTION", Sh.p.k, Bërçulle-Tiranë, Kilometri 7, pranë Kompleksit "Eno-Alba" Sh.p.k

VENDIM

Nr. 11, datë 13/04/2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "XH & L CONSTRUCTION", Sh.p.k.;

KONSTATOVA

Më datë 04/04/2012 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, "XH & L CONSTRUCTION", Sh.p.k., Bërçullë-Tiranë, e cila mbledh dhe përpunon të dhëna personale, në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të saj, me objekt:

- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, (neni 21),

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji, dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm, parashikohet: "Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë."

Gjithashtu, bazuar në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte, e konsiderojmë shkelje të rëndë përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në

Regjistrin Qëndror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Fakti që bërja publike, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit, është penguar për shak të mos njoftimit të përpunimit/ve që ju realizoni, mund të ketë penguar referencat e mundshme që subjektet specifike që ju u përpunoni të dhënat mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit/ve që ju realizoni.

Pretendimi që ju paraqitët, gjatë komunikimit me grupin inspektimit, konsiston në faktin se, shkresa me nr.1174/ES prot., e datës 07.06.2010, nisur për këtë qëllim nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ju ka ardhur. Ky pretendim nuk e justifikon, mospërbushjen e detyrimit ligjor të kontrolluesit për të njoftuar, jo vetëm për faktin që ligji “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, daton që në vitin 2008, por dhe për faktin se, shkresat sensibilizuese të iniciuara nga Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë për ti ardhur në ndihmë kontrolluesve, por jo se është një obligim ligjor i këtij autoriteti.

Ajo që vlen të theksohet, konsiston gjithashtu, në faktin që, edhe pse nga ana e grupit të inspektimit ju la një afat prej 48 orësh, për tu paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të përmbushjes së këtij detyrimi ligjor, ju përsëri nuk u paraqitët, duke përfshirë fundjavën dhe deri në datën 09.04.2012, madje jo që nuk u paraqitët, por as nuk keni komunikuar me numrat që ju vumë në dispozicion.

Nga verifikimi i regjistrave të Drejtorisë së Regjistrimit të këtij institucioni rezulton se, deri më datë 10.04.2012, ende nuk keni plotësuar formularin e njoftimit, sipas ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

-Moszbatimi i nenit 21 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma “d”, ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 lekë

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysht shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”:

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, “XH & L CONSTRUCTION”, Sh.p.k., me gjobë prej 30.000 (tridhjetëmijë) lekë.
2. Plotësimin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni të këtij vendimi.

3. Gjoba, arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi.
4. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbaarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë, 13.04.2012.

KOMISIONERI

Flora Cabej (Pogaçe)

